



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.1202/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.Nr.1202/2021 të datës 21.12.2021 të parashtruar nga ankuesja Komuna e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike *“kompensim material”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 01.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A. Nr.1202/2021 e datës 21.12.2021, e parashtruar nga ankuesja

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Obiliqit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të vendimit, ankueses t'i bëjë kompensimin e shpenzimeve për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes-nenës, në një shumë monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Obiliqit, me datë 21.12.2021, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6244/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore që organi i punësimit Komuna e Obiliqit ti bëjë kompensimin e shpenzimeve për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes (nënës).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 28.12.2021 ka

dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Obiliqit, ndërsa Këshilli me datë 12.01.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokoll 85/2022, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 1202/2021 të datës 21.12.2021 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Certifikatë-Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile E 23081353, Certifikatë e Vdekjes V 10402945 e datës 25.05.2021; përgjigje me numër protokoll III-199 e datës 15.06.2021; Kërkesën e ankueses të datës 25.05.2021 drejtuar Kryetarit të Komunës së Obiliqit; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 85/2022 e datës 12.01.2022, Vendimi me numër protokoll I-13 të datës 26.02.2014, Faturën me nr.2000 e datës 29.12.2020 të lëshuar nga Bashkësia Islame në Obiliq, Vërtetimin me numër 77 të datës 21.12.2021; të lëshuar nga Drejtoria e Administratës, Zyra e Ofiqarisë në Obiliq, e-mail i datës 28.01.2022 nga _____ për _____ emali i datës 27.01.2022 nga _____ për _____ Akt Emërimit me numër protokoll II/02 të datës 03.01.2013.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankueses *sepse:*

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës respektivisht sipas Akt Emërimit me numër protokoll II/02 të datës 03.01.2013, konstatohet se ankuesja është e punësuar në Komunën e Obiliqit, në pozitën e punës Zyrtare për Barazi Gjinore në Sektorin për të Drejtat e Njeriut. E njëjta me datë 25.05.2021 ka bërë kërkesë të Kryetari i Komunës së Obiliqit, për kompensimin e një pagë me rastin e vdekjes së nënës, ashti siç përcaktohet me Ligjin për Shërbyes Civil. Ndërsa, me datë 15.06.2021 Drejtoresha e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme të Komunës së Obiliqit, ka njoftuar ankuesen se: *" sipas kërkesës së datës 25.05.2021, duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit Komunal të Obiliqit Nr.I-13 të datës 26.02.2014, ne si institucion bëjmë vetëm pagesën e shërbimeve të varrimit për çdo qytetar të Komunës sonë"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi konstatoi se ankesa është e pranueshme në kuptim të nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës ku përcaktohet se *" Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës,* ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila kërkon që t'i behët kompensimi në rastin e vdekjes së nënës se saj, duke shtuar me tej se ankesën e bazon në dispozitat e nenit 22 paragrafi 2 pika 2.4 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenit 22, ku përcaktohet se: *2. Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim; ..2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësit civil; si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku parashihet se: ...2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, në rast të vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të*

familjes, nëpunësi civil gëzon të drejtën e ndihmës institucionale, përmes realizimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

Se kush përbënë familjen, Kolegji ju referua Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht nenit 271 ku përcaktohet se: *Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji.* Lidhur me këtë, Kolegji sjell në vëmendje Aktgjykimin A.A.nr.14/2017, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është konfirmuar përkufizimi i familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes se anëtarit të familjes.

Mbi këtë bazë, si dhe bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Certifikatës së Vdekjes me Nr. serik V 10402945 të datës 25.05.2021, konstatohet se gjegjësisht nëna e ankueses ka ndërruar jetë me datë 29.12.2020, kurse sipas Vërtetimit me Nr. 77 të datës 21.12.2021 të lëshuar nga Zyra e Ofiçarisë në Obiliq, vërtetohet se ankuesja ka jetuar me nënën e saj deri në momentin e vdekjes me datë 29.12.2020, kështu që duke iu referuar nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, për rastin e vdekjes se babait është i bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Nr. A. Nr. 1202/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ -DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së